



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E ZVEÇANIT OPŠTINA ZVEČAN ZVEČAN MUNICIPALITY	
Nr. Nisje Org. Org. Jedin. Org. Unit.	CO
Nr. Prot. Prot. Nr.	P-1-3/26
Nr. i faqesve Br. stranic No. pages	2
Data Datum Date	30. 01. 2026



Opština Zvečan
Komuna e Zveçanit
Municipality of Zvečan

Në përputhje me nenin 12, 51 dhe 52 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta Zyrtare e RK-së” nr. 28/2008), nenin 3 paragrafi 1 dhe nenin 6 pika 5 të Udhëzimit Administrativ të MLS-së nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjes dhe kompetencave të komiteteve të përhershme, si dhe nenet 9 dhe 29 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Zveçanit, duke marrë parasysh vlerësimin e ligjshmërisë të Vendimit paraprak për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (nr. 020-4/1, datë 14.01.2026), me të cilin ministria kompetente ka theksuar nevojën e harmonizimit dhe ka urdhëruar nxjerrjen e një akti të ri, Kuvendi i Komunës së Zveçanit, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, në seancën e tij të 1-rë (të parë) të rregullt në vitin 2026, të mbajtur më datë 30.01.2026, njëzëri miraton:

VENDIM

për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data Datum Date.	13.02.2026	
Njesia organizative	Nr. i Lendes	Vlera
-VI-	020-121	

Neni 1

Me këtë vendim formohet Komiteti për Politikë dhe Financa si komitet i përhershëm i Kuvendit të Komunës së Zveçanit.

Neni 2

Komiteti nga neni 1 i këtij vendimi formohet në përbërjen si në vijim:

1. Dr. Srdjan Milosavljević, Kryetar i Kuvendit Komunal të Zveçanit – Kryetar i Bordit (sipas funksionit)
2. Jelena Nikić – Anëtare (LS)
3. Ivana Đokić – Anëtare (LS)
4. Časlav Sofronijević – Anëtar (LS)
5. Zoran Obrenović – Anëtar (DS)

Neni 3

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë të komiteteve të tjera, në përputhje me dispozitat në fuqi dhe Udhëzimin Administrativ të MLS-së nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjes dhe kompetencave të komiteteve të përhershme.

Neni 4

Komitetin për Politikë dhe Financa e kryeson kryetari i Komitetit nga neni 2 paragrafi 1 pika 1 e këtij vendimi. Në rast të mungesës së kryetarit të Komitetit, mbledhjen e Komitetit e udhëheq anëtari më i moshuar i Komitetit.

Neni 5

Komiteti për Politikë dhe Financa shqyrton çështjet nga kompetenca e tij në përputhje me nenin 52 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MLS-së nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjes dhe kompetencave të komiteteve të përhershme.

Neni 6

Mandati i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa zgjat sa mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës, përkatësisht pushon me përfundimin e mandatit të anëtarit të Kuvendit, në përputhje me dispozitat në fuqi, dhe është i përcaktuar me nenin 12 të Udhëzimit Administrativ të MLS-së nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjes dhe kompetencave të komiteteve të përhershme.

Neni 7

Ky vendim miratohet si akt i ri i harmonizuar për veprim sipas urdhrit të ministrisë kompetente (nr. 020-4/1, datë 14.01.2026) nga procedura e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit paraprak. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon së vlefshmi Vendimi paraprak i Kuvendit të Komunës së Zveçanit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa (nr.: P-1-3, datë: 18.12.2026).

Neni 8

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Zveçanit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dergimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

Kryetari i Kuvendit të Komunës së
Zveçanit

Dr. Milan Milosavljević

